


19.01.2018

01 400 4129



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT



**RAPORTI VJETOR I BUXHETIT
PËR VITIN 2017**

Drenas, janar 2018

RAPORTI VIETOR I BUXHETIT PËR VITIN 2017

Baza e përgatitjes

Raporti është përgatitur në pajtim me LMFP(03/L-048) të ndryshuar me Ligjin 04/L-221, dhe SNKSP bazuar në para të gatshme- Raportimi financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Baza e kontabilitetit dhe raportimit, tani më në Kosovë është sipas LMFP-së baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuar në këtë raport paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme. Menaxhimi i parasë është i organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohën për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve të cilat i kontrollojnë Institucion i vetëm - Departamenti i Thesarit-M.F. Vlen të ceket se politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërësisë fiskale. Ligji nr.03/L-048 për MFPP, përkatësisht nen 46.2 kërkon që Kryetari i Komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë Kuvendit Komunal një raport përfundimtar buxhetor i cili paraqet gjendjen e zhvillimit të buxhetit për një vit fiskal, raporti më pas publikohet në faqen zyrtare të komunës me qëllim të përmblidhjes së principit të transparencës. Në mirëpresim çdo koment që do të kontribonte pozitivisht në përmirësimin e raporteve të ardhshme.

Ndarjet Buxhetore

Ligji Nr.05/L-125 i paraqet ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2017. Ky ligj përfshin edhe mekanizma që mundësojnë ndryshime të këtyre ndarjeve buxhetore gjatë vitit, këto mekanizma përfshijnë:

- *Ndarjen buxhetore të disa llojeve të të hyrave vetanake të mbledhura nga fushat kryesore të të hyrave në vitin paraprak e të pa shpenzuara;
- *Ndarjen buxhetore nga të hyrat vetanake të planifikuara për arkëtim gjatë vitit 2017 sipas fushave kryesore të të hyrave dhe sipas sektorëve kryesorë;
- *Ndarjen buxhetore nga grantet ndërqeveritare sipas programeve - nënprogrameve, si dhe
- *Ndarjen buxhetore nga grantet e donatorëve.

1.Ndarjet Fillestare buxhetore sipas Ligjit Nr.05/L-125, shprehur në euro(€)

Nr	Programet	Paga & Mëd.	Mallra & Shërbime	Sh.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Totali	Stafi
1	Zyra e Kryetarit	109,923.00	26,000.00		10,000.00		145,923.00	11
2	Administrata dhe Personeli	206,729.00	72,800.00	1,400.00	3,000.00	95,500.00	379,429.00	43
3	Inspektioni	59,172.00	23,200.00				82,372.00	9
4	Zyra e Kuvendit Komunal	107,900.00	19,900.00				127,800.00	
5	Buxhet dhe Financa	89,524.00	12,600.00			15,000.00	117,124.00	14
6	Sherbimet Pub. Emergjente	135,288.00	91,292.00	42,000.00	8,000.00	345,000.00	621,580.00	23
7	Zyra Kom. per Komunitete	7,512.00	3,544.00				11,056.00	1
8	Bujqësi pylltari dhe zhvill	76,359.00	20,000.00		50,000.00		146,359.00	13
9	Kataster dhe Gjeodezi	74,144.00	7,710.00			100,000.00	181,854.00	12
10	Planifikimi Urban Mjedisor	55,264.00	11,000.00			2,388,539.00	2,454,803.00	9
11	Kulturë Rini dhe Sport	63,739.00	31,160.00		100,511.00	270,000.00	465,410.00	13
12	Shëndetësia	1,263,502.00	246,527.00	44,360.00	20,552.00	205,000.00	1,779,941.00	200
13	Arsimi	5,608,836.00	498,861.00	70,100.00	20,000.00	429,791.00	6,627,588.00	964
	Totali	7,857,892.00	1,064,594.00	157,860.00	212,063.00	3,848,830.00	13,141,239.00	1,312

Tabela e parë paraqet buxhetin fillestar - të planifikuar për vitin fiskal 2017 në shumë prej: 13,141,239.00 euro. Financimi i buxhetit është paraparë të bëhet nga dy burime kryesore të të hyrave dhe atë:

- a) Grantet Qeveritare në shumë prej: 11,667,234.00 euro; apo 88.78 %;
- b) Të Hyrat nga Burimet Vetanake në shumë prej: 1,474,005.00 euro apo 11.22 %.

Shpërndarja e buxhetit për nga karakteri ekonomik është paraparë të jetë në pesë kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, ndërsa për nga karakteri funksional në 13 programe - nënprograme.

Zhvillimi dhe analiza e Buxhetit Komunal për vitin 2017

Për deri sa buxheti paraqet planifikimin e të hyrave dhe të dalave, raporti financiar paraqet një pasqyrë të bilancit për të hyrat dhe të dalat-shpenzimet e realizuara në raport me planifikimin, për këtë të dhënë përmblidhëse për vitin fiskal 2017 do të pasqyrohen në tabelën e më poshtme.

2.Skema buxhetore për vitin 2017 shprehur në euro

Përshkrimi	Buxheti final	Ndarjet buxhet.	Shpenzimi 2017	% buxh. final	% buxh.ndar
Granti (10) 2017	11,612,841.64	11,612,841.64	11,237,192.76	96.77	96.77
Të hyrat vetanake (21) 2017	1,474,005.00	1,109,604.49	814,617.74	55.27	73.42
Të hyrat vetanake (22) 2016	514,669.00	514,669.00	425,819.53	82.74	82.74
Grantet e donatorëve (31)	9,623.52	9,623.52	6,045.00	62.81	62.81
Totali	13,611,139.16	13,246,738.65	12,483,675.03	91.72	94.24

Koment: Të dhënat janë marrë nga Raporti i SIMFK-së i datës 18.01.2018, ora 10:50.

Tabela e lart shënuar paraqet zhvillimin e buxhetit komunal 2017 për nga burimet e financimit si për nga të hyrat, e po ashtu edhe për të dalat publike. Nëse bëjmë një krahasim të buxhetit fillestar (13,141,239.00 euro) dhe atij të ndarë në shumë prej 13,246,738.65 euro, del se kemi patur një zhvillim për 100.80%, ndërsa ndarja e buxhetit final(13,611,139.16€) është e realizuar për 97.32%.

Grantet Qeveritare me buxhet kanë qenë të planifikuara në shumë prej:11,667,234.00 €, ndërsa sipas raportit të SIMFK-së janë alokuar në shumë prej:11,612,841.64€, apo 99.53%. Të Hyrat nga Burimet Vetanake (21) janë alokuar në shumë prej:1,109,604.49€, apo 89.50% e shumës së arkëtuar

prej:1,239,798.15€. Të hyrat vetanake të arkëtuara dhe të pashpenzuara barten me vendim të Kuvendit Komunal pa ndonjë shkurtim në vitin 2018. Mjetet e ndara në shumë prej:13,246,738.65€ të krahasuara me shumën e shpenzuar prej:12,483,675.03 € paraqesi zhvillimin e buxhetit për të dalat-shpenzimet shprehur në përqindje prej 94.24%. Për nga burimi i financimit Grantet Qeveritare paraqesin shkallën e shpenzimit më të lartën, apo 96.77%, kjo për faktin se mbajtësit e buxheteve i kanë kushtuar rëndësi më të madhe projekteve të financuara nga ky burim i financimit.

Të hyrat e burimeve vetanake janar - dhjetor 2017.

Tabela nr.3

		Shprehur në euro (€)		
Nr	Fushat e të hyrave	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Përqindja
1	Talimi në pronë	361,975.35	390,313.17	107.83
2	Taksa dhe ngarkesa	601,124.65	630,350.33	104.86
a)	Gjithsej Adm. Direkte	963,100.00	1,020,663.50	105.98
3	Gjobat nga Gjykatat	27,640.00	25,320.00	91.61
4	Gjobat nga Trafiku	47,303.50	135,153.50	285.72
5	Donacionet	8,273.00	6,045.00	73.07
b)	Gjithsej Adm.Indirekte	83,216.50	166,518.50	200.10
a+b	Gjithsej	1,046,325.59	1,187,182.00	113.46
	Participimi Shendetësi	28,474.50	31,328.40	110.02
c)	Gjithsej Shendetësia	28,474.50	31,328.40	110.02
	Participimi qerdhe	24,265.75	21,287.75	87.73
	Part SH.M.F Lladrovci			
d)	Gjithsej Arsimi	24,265.75	21,287.75	87.73
	Raporti Përmbledhes	1,099,065.84	1,239,798.15	112.80




Tabela e lart shënuar paraqet arkëtimin e të hyrave vetanake sipas sektorëve dhe fushave kryesore të të hyrave për vitin 2017, krahasuar me vitin 2016. Krahasuar planifikimin me arkëtimin, vërehet se kemi një mos realizim të objektivit për -15.89%. Ndikimin më të madh në mos realizim të objektivit e kanë pasur të hyrat indirekte, të cilat nuk varen nga aktivitetet komunale. Të hyrat direkte me plan shprehur në përqindje janë realizuar 103.20%, për deri sa të hyrat indirekte vetëm 84.86%. Shikuar në aspektin sektorjal, Sektori i Përgjithshëm ka patur një performancë më të mirë se dy sektorët tjerë. Nëse bëjmë një krahasim me një vit më parë (2016) kemi një ngritje të performancës në drejtim të arkëtimit për +12.80%. Dallimi (-15.89%) në mes të planifikimit (1,474,005.00€) dhe arkëtimit (1,239,798.15€) është se kufiri i të hyrave vetanake është i imponuar.

Komuna i menaxhon shpenzimet përmes llogarisë së vetme të Thesarit (LVTH) e cila mbulohet në Autoritetin Bankar të Kosovës (AQBK) me nr.1000650070000022.

Proqesi i shpenzimeve është i përfshirë në disa koncepte kryesore lidhur me shpenzimin e parave publike dhe atë:

- * Ndarja buxhetore
- * Akordimi i fondeve
- * Iniciimi i shpenzimit,
- * Zotimi i fondeve,
- * Autorizimi i shpenzimeve
- * Prokurimi,
- * Çertifikimi - Aprovimi,

* Pagesa e faturës dhe

* Lëshimi i fondeve nga llogaria bankare.

Për t'u bërë ngritja dhe promovimi i ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë së shpenzimit të parasë publike, nga programet - nënprogramet me kohë është bërë përgatitja e parashikimit paraprak të zotimeve dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin fiskal 2017. Ndarja e buxhetit në programe - nënprograme si dhe projekte ka patur një ndikim pozitiv në drejtim të realizimit të një menaxhimi më të mirë dhe transparent të parasë publike.

Shpenzimet ndahen përnga karakteri funksional në programe - nënprograme, ndërsa përnga karakteri ekonomik në pesë kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, zhvillimin e të cilave e pasqyrojnë tabelat në vijim shprehur në euro:

Tabela 4 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve - Zyra e Kryetarit.

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	107,785.37	107,785.37	107,227.78	99.48	99.48
Mallra dhe Shërbime	27,337.38	27,337.38	24,043.43	87.95	87.95
Sh.Sherbimeve Komunale					
Subvencione - Transfere	10,000.00	10,000.00	7,000.00	70.00	70.00
Shpenzimet Kapitale					
Totali	145,122.75	145,122.75	138,271.21	95.28	95.28

Tabela 4.1 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtoria e Administratës .

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	206,912.26	206,912.26	206,055.11	99.59	99.59
Mallra dhe Shërbime	72,800.00	72,800.00	69,081.63	94.89	94.89
Sh.Sherbimeve Komunale	1,401.41	1,401.41	1,398.00	99.76	99.76
Subvencione - Transfere	3,000.00	3,000.00	2,770.00	92.33	92.33
Shpenzimet Kapitale	95,500.00	82,540.00	68,034.63	71.24	82.43
Totali	379,613.67	366,653.67	347,339.37	91.50	94.73

Tabela 4.2 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtoria e Inspeksionit .

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	57,341.85	57,341.85	57,250.47	99.84	99.84
Mallra dhe Shërbime	23,200.00	23,200.00	20,833.07	89.80	89.80
Sh.Sherbimeve Komunale					
Subvencione - Transfere					
Shpenzimet Kapitale					
Totali	80,541.85	80,541.85	78,083.54	96.95	96.95

Tabela 4.3 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Zyra e Kuvendit Komunal

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	84,414.60	84,414.60	83,576.62	99.01	99.01
Mallra dhe Shërbime	19,900.00	19,900.00	13,854.64	69.62	69.62
Sh.Sherbimeve Komunale					
Subvencione - Transfere					
Shpenzimet Kapitale					
Totali	104,314.60	104,314.60	97,431.26	93.40	93.40

Tabela 4.4 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	78,207.18	78,207.18	77,641.37	99.28	99.28
Mallra dhe Shërbime	12,600.00	12,600.00	12,407.13	98.47	98.47
Sh.Sherbimeve Komunale					
Subvencione - Transfere					
Shpenzimet Kapitale	15,000.00	15,000.00	15,000.00	100.00	100.00
Totali	105,807.18	105,807.18	105,048.50	99.28	99.28

Tabela 4.5 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	123,335.49	132,335.49	132,187.60	99.89	99.89
Mallra dhe Shërbime	91,992.00	91,992.00	85,152.58	92.57	92.57
Sh.Sherbimeve Komunale	91,298.00	91,298.00	90,959.63	99.63	99.63
Subvencione - Transfere	9,371.95	9,371.95	7,500.00	80.03	80.03
Shpenzimet Kapitale	345,000.00	340,826.33	284,426.72	82.44	83.45
Totali	669,997.44	665,823.77	600,226.53	89.59	90.15

Tabela 4.6 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Zyra për Komunitete dhe Kthim

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	8,319.85	8,319.85	7,537.62	90.60	90.60
Mallra dhe Shërbime	3,544.00	3,544.00	2,137.18	60.30	60.30
Sh.Sherbimeve Komunale					
Subvencione - Transfere					
Shpenzimet Kapitale					
Totali	11,863.85	11,863.85	9,674.80	81.55	81.55

Tabela 4.7 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	74,018.67	74,018.67	72,147.68	97.47	97.47
Mallra dhe Shërbime	20,000.00	20,000.00	18,455.94	92.28	92.28
Sh.Sherbimeve Komunale					
Subvencione - Transfere	51,371.95	51,249.18	41,866.23	81.50	81.69
Shpenzimet Kapitale	9,014.88	9,014.88	6,045.00	67.06	67.06
Totali	154,405.50	154,282.73	138,514.85	89.71	89.78

Tabela 4.8 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtoria për Gjeodozi dhe Pronë

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	74,626.72	74,626.72	74,626.72	100.00	100.00
Mallra dhe Shërbime	7,710.00	7,710.00	4,945.23	64.14	64.14
Sh.Sherbimeve Komunale				-	-
Subvencione - Transfere				-	-
Shpenzimet Kapitale	100,000.00	20,000.00		-	-
Totali	182,336.72	102,336.72	79,571.95	43.64	77.76

Tabela 4.9 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve - Drejtoria për Urbanizem dhe Planifikim Hapsinor

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	57,726.78	57,726.78	55,411.45	95.99	95.99
Mallra dhe Shërbime	11,000.00	11,000.00	10,288.23	93.53	93.53
Sh.Sherbimeve Komunale				-	-
Subvencione - Transfere				-	-
Shpenzimet Kapitale	2,852,533.21	2,654,819.39	2,272,817.32	79.68	85.61
Totali	2,921,259.99	2,723,546.17	2,338,517.00	80.05	85.86

Tabela 4.10 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	62,330.12	62,330.12	62,259.81	99.89	99.89
Mallra dhe Shërbime	31,160.00	31,160.00	28,857.25	92.61	92.61
Sh.Sherbimeve Komunale				-	-
Subvencione - Transfere	100,511.00	100,511.00	93,510.50	93.04	93.04
Shpenzimet Kapitale	270,000.00	270,000.00	264,598.93	98.00	98.00
Totali	464,001.12	464,001.12	449,226.49	96.82	96.82

Tabela 4.11 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale


Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	1,245,837.48	1,245,837.48	1,241,900.54	99.68	99.68
Mallra dhe Shërbime	249,712.65	249,712.65	224,253.83	89.80	89.80
Sh.Sherbimeve Komunale	44,360.00	44,360.00	43,128.63	97.22	97.22
Subvencione - Transfere	22,012.43	22,012.43	19,090.00	86.72	86.72
Shpenzimet Kapitale	205,000.00	190,000.00	148,596.70	72.49	78.21
Totall	1,766,922.56	1,751,922.56	1,676,969.70	94.91	95.72

Tabela 4.12 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Drejtorati për Arsim

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	5,597,613.27	5,597,613.27	5,584,393.63	99.76	99.76
Mallra dhe Shërbime	506,485.80	493,355.55	451,886.33	89.22	91.59
Sh.Sherbimeve Komunale	70,100.00	70,100.00	70,099.85	100.00	100.00
Subvencione - Transfere	20,000.00	20,000.00	-	-	-
Shpenzimet Kapitale	430,752.89	389,452.89	318,420.02	73.92	81.76
Totall	6,624,951.96	6,570,521.71	6,424,799.83	96.98	97.78

Tabela 5. - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve -Buxheti Komunal

Përshkrimi	Buxheti 2017	Ndarja 2017	Shpenzimi vjetor	% ndaj plan.	% ndaj ndarj.
Paga dhe Mëditje	7,787,469.64	7,787,469.64	7,762,216.40	99.68	99.68
Mallra dhe Shërbime	1,077,441.83	1,064,311.58	966,196.47	89.68	90.78
Sh.Sherbimeve Komunale	207,159.41	207,159.41	205,586.11	99.24	99.24
Subvencione - Transfere	216,267.33	216,144.56	171,736.73	79.41	79.45
Shpenzimet Kapitale	4,322,800.98	3,971,653.49	3,377,939.32	78.14	85.05
Totall	13,611,139.19	13,246,738.68	12,483,675.03	91.72	94.24



Tabelat 4 deri të 4.12, paraqesin zhvillimin e buxhetit komunal lidhur me shpenzimet sipas karakterit ekonomik (në pesë kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve) dhe në aspektin programor në trembëdhjetë (13) programe-nënprograme buxhetore, duke krahasuar planifikimi dhe ndarjet me shpenzimin, ndërsa tabela nr.5 pasqyron përmbledhjen e të dhënave për zhvillimin e buxhetit komunal sipas kategorive kryesore të shpenzimeve. Nëse bëjmë një krahasim në mes të ndarjeve buxhetore (13,246,738.65€) dhe shpenzimit (12,483,675.03€) vërehet se për vitin raportues realizimi i shpenzimeve, shprehur në përqindje është prej:94.24%. Krahasuar me një vit më parë shkalla e shpenzimit të buxhetit ka patur rritje për +7.54%. Nëse në vitin 2017 ka patur bartje të hyrave vetjake në shumë prej:514,662.75€, në vitin fiskal 2018, bartja e mjeteve nga të hyrat vetjake përafërsisht do të jetë në shumë prej:507,987.88€, kjo tregon se mundësit e pagesave të papaguara do të rritën, kjo shumë e mjeteve do ta përmirëson shkallën e shpenzimit (94.24%) në 98.07%.

Edhe pse të gjitha faturat e paraqitura për pagesë nga programet-nënprogramet buxhetore janë paguar në afatin ligjor, prap kemi obligime të pa paguara të mbetura për pagesë në vitin 2018. Vlerë e llogarive të pagueshme është në shumë prej: 37,313.45€, apo krahasuar me një vit më parë për:140,485.71€ më e vogël. Vlenë të cekët se një pjesë e obligimeve e kanë buxhetin e bartur për pagesë, përmes mjeteve për bartje.

Vlera e detyrimeve kontigjente (një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve në të ardhmën) është i planifikuar në shumë prej:149,319.88€. Numri i të punësuarve me buxhetin e vitit 2017 ka qenë i lejuar në nr.1312 punëtor, në Sektorin e Përgjithshëm dhe atë të Shëndetësisë ka mbetur pa u shfrytëzuar totali i lejuar; ndërsa në Sektor të Arsimit numëri ka variuar sipas nevojës së Sektorit.

Bazuar në Rregulloren MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore është bërë regjistrimi i pasurive jo financiare kapitale të evidentuara në vlerë prej:3,294,213.93€, ndërsa totali i pasurive jo financiare kapitale më 31.12.2017 është në vlerë :500,032,824.00 €. Në këtë vlerë janë të përfshira tokat, ndërtesat, pajisjet, Infrastruktura, si dhe automjetet pasuri komunale.

Vlenë të theksohet se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.10/19 datë:15.12.2017, Komuna e Drenasit ka përfutur mjete shtesë në shumë prej:49,998.00€ në Kategorinë Ekonomike të Shpenzimeve Komunale dhe si rezultat komuna ka bërë pagesën e të gjitha borxheve për shërbime komunale. Edhe pse ne si Organizatë Buxhetore e kemi miratuar Rishikimin e Buxhetit 2017 sipas Instruksionit të lëshuar nga Ministria për Financa, Rishikimi s'është realizuar në nivel Vendi për komuna, kjo kapatur ndikim në performancën e zhvillimit të buxhetit 2017. Vlera e përgjithshme e buxhetit të rishikuar ka qenë në shumë prej:79,000.00€. Gjatë vitit fiskal 2017 janë realizuar të gjitha kërkesat e mbajtësve të buxhetit lidhur me rialokimet dhe ridestinimet buxhetore, procedura këto të cilat e kanë pasur efektin pozitiv në zhvillim të buxhetit për të dalat-shpenzimet.

